



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më dt. 10.9.2024, me fillim në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi Rexha, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Adnan Ajeti.

**Munguan:** Triera Kasumi Berisha, Faton Marolli.

**Në mbledhjen morën pjesë edhe:** Betim Abdullahu - shef i ZKKK-ës, Klaudia Mula, zyrtare për komunitete në ZKKK, Qefsere B Veseli - zyrtare në ZKKK, përfaqësuesit e KFOR-it LMT, Valbona Ajeti - drejtore e administratës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete znj. Mirsada Behluli me këtë:

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Formimi i grupit për vizitë në shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë, si në shkollën: “Asim Vokshi”, “Emin Duraku” dhe shkollat tjera.

**Qëllimi i vizitës:**

- a) Identifikimi i rasteve specifike të nxënësve me ndihmë sociale nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian;
  - b) Identifikimi i secilit person dhe arsyt për mosvijimin e mësimi;
3. Analiza e pozitës sociale të përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë:
    - a) Miratimi i listës për dru zjarri;
  4. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës, znj. Valbona Ajeti;
    - a) Numri i të regjistruarve nga komunitetet ashkali dhe rom;
    - b) Problemet lidhur me lëshimin e dokumenteve personale në gjuhën serbe dhe turke;
  5. Raporti i ZKKK-ës për muajin gusht 2024;
  6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
  7. Të ndryshme.

Faqe 1 nga 6

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

**Pika e parë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit nga mbledhja e kaluar e Komitetit**

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Pika e dytë**

**Formimi i grupit për vizitë në shkollat ku vijnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë, si në shkollën: “Asim Vokshi”, “Emin Duraku” dhe shkollat tjera.**

**Qëllimi i vizitës:**

**a) Identifikimi i rasteve specifike të nxënësve me ndihmë sociale nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian;**

**b) Identifikimi i secilit person dhe arsyet për mosvijimin e mësimin.**

**Mirsada Behluli** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se ne duhet t’i formojmë grupet të cilat do të shkojnë nëpër shkollat e lartpërmendura. Për komunitetin turk propozohet komisioni me këtë përbërje: Oktay Kurtesh, përfaqësuesi i ZKKK-ës, zakonisht Klaudia ka qenë pjesë përbërëse e komisionit nga ZKKK dhe Elmira Nikçi Rexha.

**Për komunitetin ashkali propozohet komisioni me këtë përbërje: Klaudia Mula nga ZKKK, Faton Marolli dhe Elmira Nikçi Rexha.**

**Për komunitetin rom propozohet komisioni me këtë përbërje: Klaudia Mula nga ZKKK, Adnan Ajeti dhe Elmira Nikçi Rexha.**

**Për komunitetin boshnjak dhe goran propozohet komisioni me këtë përbërje: Slavica Stolic, Kimeta Shok dhe Elmira Nikçi Rexha.**

A pajtoheni me propozimin. Njëzëri u miratua propozimi i komisioneve për vizitë në shkolla ku vijnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë duke përfshirë edhe përfaqësuesit e KFOR-it të cilët kanë shprehur dëshirën të jenë pjesë përbërëse e komisionit.

**Pika e tretë**

**Analiza e pozitës sociale të përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë:**

**a) miratimi i listës për dru zjarri**

**Betim Abdullahu** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se sa i përket listës për dru zjarri ju veç keni pasur rast me e pa, ndoshta edhe Klaudia dëshiron të ndërlihet pak në diskutim, por po ua them një informatë jozyrtare ku me një bisedë që e kam pasur me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale nuk na e kanë konfirmuar realisht që ka me na u përkrah komplet lista për shkak të shkurtimit të buxhetit.

Ai në vazhdim tha se ju e dini që edhe vitin e kaluar e kemi pasur të njëjtin problem dhe unë kam kërkuar që të paktën me na lajmëruar më herët, pra një muaj apo një muaj e gjysmë më herët qysh kishim mundur me gjetur një zgjidhje ose përmes kryetarit, ose përmes burimeve tjera. Arsyeja se pse ne i kemi dorëzuar listat në pranverë ka qenë që me fut në buxhet që mos me pasur ne telashe të përhershme sa herë po vjen koha për dru zjarri. Pra po presim një konfirmim përfundimtar të listës nga drejtoria përkatëse ku do të jeni të informuar, pasi që lista është ashtu siç e keni dorëzuar nuk është përmirësuar asgjë. Mirëpo nëse bëhet shkurtimi i listës ajo nuk varet prej neve.

**Elmira Nikçi Rexha** – shtroi pyetje se sa është lista përfundimtare që e kanë dorëzuar komunitetet joshumicë.

**Klaudia Mula** - lidhur me pyetjen e shtuar tha se numri përfundimtar është 192 familje. Ajo në vazhdim tha se në pranverë është dorëzuar si lloj projekti për me u planifikuar për buxhet, ndërsa unë tash kisha propozuar me shkuar me një lloj të kërkesës direkt në drejtori dhe të presim një përgjigje zyrtare.

**Elmira Nikçi Rexha** - duke iu drejtuar znj. Mulla tha se ndoshta kishe mundur me na treguar në pika të shkurta se si janë të renditura familjet e të shkojmë ta votojmë listën.

**Klaudia Mulla** – tha se nga komuniteti rom janë pesë familje, komuniteti ashkali 112 familje, komuniteti boshnjak katër familje, komuniteti goran tetë familje, komuniteti turk 35 familje, komuniteti serb 28 familje. Komplet lista është 192 familje. Njëzëri u miratua lista.

#### **Pika e katërt**

**Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës, znj. Valbona Ajeti.**

**a) numri i të regjistruarve nga komunitetet ashkali dhe rom;**

**b) problemet lidhur me lëshimin e dokumenteve personale në gjuhën serbe dhe turke.**

**Valbona Ajeti** - lidhur me pyetjet e shtruara nga ana e kryesueses dhe anëtarëve të Komitetit për Komunitete tha se nga data 15 prill deri më datë 15 maj të vitit 2024, në Komunën e Prishtinës ka qenë e hapur fushata për regjistrimin falas për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Ajo në vazhdim tha se të gjitha komunitetet në fjalë kanë mundur të bëjnë regjistrimin falas të aktit të lindjes dhe dokumenteve të tjera të gjendjes civile në të gjithë territorin e Komunës së Prishtinës, ku 50 qytetarë të cilët kanë poseduar librezat e Qendrës për Punë Sociale janë liruar nga pagesa dhe janë pajisur me dokumentet e gjendjes civile. Pra kjo shifër është që janë pajisur me dokumente të gjendjes civile e jo që janë regjistruar për dokumente të lindjeve të reja. Pra kjo do të ishte informata ime nga zyrtarët e gjendjes civile, nëse keni diçka urdhëroni, ndërsa lidhur me problemin e lëshimit të dokumenteve

personale në gjuhën turke dhe serbe tha se nga informatat që i kam marrë nga zyrtarët e mi duke e ditur se gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare, prandaj edhe bëhet lëshimi në dy gjuhët, ndërsa gjuha turke nuk është gjuhë zyrtare. Ajo në vazhdim tha se këtë pikë do ta shtyj në Kuvendin

e Kryeqytetit së bashku me grupin tonë parlamentar dhe besoj se kjo pikë do të kalojë që gjuha turke të ketë mbështetje në Kuvend.

**Oktay Kurtesh** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se nuk është problem vetëm gjuha turke, por kërkesa është se me ligj e kemi të drejtë atë me e marr pra dokumentin në gjuhën turke, edhe se nuk është hera e parë që shtrohet ky problem, por ka vite me radhë. Ai në vazhdim tha se nuk kërkoj që gjuha turke të jetë e domosdoshme siç është gjuha shqipe dhe ajo serbe, mirëpo të jetë pjesë përbërëse kur dokumenti të shkruhet në gjuhën shqipe dhe serbe të shkruhet edhe në gjuhën turke.

**Elmira Nikçi Rexha** – sa i përket gjuhës turke me u fut si gjuhë zyrtare në Kuvendin Komunal të Prishtinës, pa asnjë hezitim ne e mbështesim mirëpo ne duhet me e pa ligjin e normal ligji neve si Kuvend komunal nuk na e lejon se është Ligj i Qeverisë, që e ka bazën e përqindjen edhe ne duhet me pritur regjistrimin e fundit të popullsisë me e pa se sa kanë dal turq edhe qeveria e miraton atë ligj dhe ua shpërndan përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal. Pra është kompetencë e Qeverisë e jo e komunës. Pas ca diskutimesh, sugjerimesh ajo tha se ju siguroj që e ka miratimin e të gjithë neve.

**Mirsada Behluli** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se komuniteti turk është më i madhi në numër në Komunën e Prishtinës në krahasim me komunitetet tjera dhe mendoj se do duhej të përkrahet edhe pse e kam kuptuar këtë diskutim që e bëtë, pra është mirë që t'ju ndihmohet.

**Valbona Ajeti** – tha se pajtohem me Elmirën për atë çka e tha se pa e konsultuar ligjin paraprak ne nuk mund të themi asgjë pasi që është në nivel qendror, ndërsa ne vetëm mund ta shtyjmë përpara. Ajo në vazhdim tha se besoj se edhe për gjuhën serbe qytetarët nuk kanë ndonjë problem lidhur me dokumentet e tyre për aq sa kam informacione nga zyrtarët e mi.

**Nenad Miladinovic** – tha se sa i përket komunitetit serb jam i njoftuar mjaft lidhur me ndryshimet dhe ka shumë probleme. Më herët ka qenë se në sistem nuk kanë qenë të kyçura emërtimi i rrugëve, sidomos në vendet rurale, si dhe emri i rrugëve gjithmonë është i shënuar në gjuhën shqipe. Ai në vazhdim tha se ka pasur rastin personal të vetin ku para ca ditësh ka ndërruar letërnjoftimin dhe se gjithsesi kanë kërkuar që të bëhet ndryshimi, të futet adresa e rrugës dhe të bëhet ndryshimi në gjuhën serbe pra në ekstrakt të lindjes, ku i është dashur dy herë të kthehet nga Ministria në komunë që të përmirësojë përmirësimin e gabimeve teknike në ekstrakt të lindjes, pasi që për shkak të këtyre gabimeve ndonjëherë ndonjë qytetar duhet të vijë në Prishtinë për të rregulluar ndonjë çështje. Prandaj vetëm se kisha me ju sugjeruar zyrtarëve kompetentë që gjatë punës të kenë kujdes në shkrim, unë të gjitha këto po i kuptoj edhe të gjitha këto leht mund të përmirësohen sidomos për neve që jetojmë në territorin e Bashkësisë Lokale të Bardhoshit. E kemi aty zyrtarin me emrin Sabri i cili e flet shumë mirë gjuhën serbe, ka komunikim të mirë me të gjithë atje dhe ne shumë leht i kryejmë punët atje.

**Oktay Kurtesh** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se sa i përket certifikatave të lindjes edhe ne po kemi problem kur po shkojmë në Turqi për studime, pra na nevojitet dokumenti në gjuhën turke për të dëshmuar se jemi të komunitetit turk.

**Elmira Nikçi Rexha** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se ajo ka ndodhur nëpër Bashkësi lokale para 12 vjetëve, që do të thotë se qe 12 vjet ai dokument nuk jepet. Mirëpo nëse ka kërkesa kjo është shumë e thjeshtë se drejtoresha e përdor anën e vet dhe nëpërmes Bashkësive lokale me e bë një shabllon aty në njëfarë forme sikur dëshmia e vendbanimit që lëshohet mundet me u lëshuar edhe ky dokument.

**Valbona Ajeti** – duke iu drejtuar znj. Behluli tha se problemin si tuajin e kam pasur edhe unë tek mbiemri nga Vitia me Vitija. Unë do t'ua jap zyrtarisht një informatë e di që me dëshmitarë e patëm ndryshuar, por unë do t'ua jap përgjigjen më zyrtarisht. Tek dokumenti me dëshminë se jeni të komunitetit turk e të tjerë po besoj se ky është një dokument i cili është lëshuar nga zyrtarët e Bashkësive lokale. Ajo mes tjerash tha se nëse pala shkon tek një zyrtare e cila nuk e njih gjuhën turke apo serbe, atëherë vazhdon tek zyrtari tjetër i cili e njih gjuhën.

**Betim Abdullahu** – tha se sa për informatën tuaj Drejtoria e Shërbimeve Publike është duke vendosur kontejnerë të mëdhenj për mbeturina interne, dhe ju kisha sugjeruar të kontaktoni me zyrtarin e drejtorisë Dukagjinin që nëse keni nevojë ndonjë pjesë të Bërnicsës ku ka mbeturina më të mëdha që i gjuajnë p.sh mbeturina jo të përditshme, atëherë vjen kompania me i marr dhe mos të krijohen deponi të theksuara.

**Nenad Miladinovic** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se ne nuk kemi problem me kompaninë e cila kryen shërbimet pasi që ata janë vërtet korrekt, një herë në javë vijnë e i mbledhin mbeturinat. Ne kemi problem me hedhjen e mbeturinave në hapësira jolegale.

**Elmira Nikçi Rexha** – tha se Betimi e dha një informatë tjetër d.m.th për kontejnerët e mëdhenj për mbeturina të vëllimshme. Ajo në vazhdim tha se tash në çdo lagje në bazë të orarit i kanë ndarë d.m.th nëse personat kanë me e gjuajtur ndonjë divan, apo karrige ose këso gjëra që nuk janë për t'ua gjuajtur në kontejnera të vogël, tash secila lagje e ka orarin e ndarë dy herë në javë, e ka atë mundësi me i gjuajtur ato mbeturinat e mëdha e jo me i lënë afër kontejnerëve, ndërsa për këto deponitë duhet me u adresuar prapë tek shërbimet publike se duhet me u larguar.

#### **Pika e shtatë**

##### **Të ndryshme**

**Mirsada Behluli** – duke iu drejtuar z. Kurtesh tha se ke shprehur dëshirë që të caktojme një takim te kryeministri të cilin e kemi lënë për shtator, atëherë nëse vlen kjo dëshirë ende, ta organizojmë një grup nëse ke diçka speciale.

**Elmira Nikçi Rexha** - tha se e ke pasur kërkesë, pasi ka qenë kërkesë tani e realizoni si grup, ti shkon me kërkesat tua për gjuhën turke pse nuk është gjuhë zyrtare, komuniteti boshnjak shkon me kërkesat e veta për tekste shkollore etj, mandej vini na tregoni se çka ju kanë thënë ata dhe çka mundemi me bë bashkërisht. Si përfundim duke iu drejtuar z. Miladinovic dhe z. Oktay tha se duhet të bëjnë kërkesë në organet përkatëse e pastaj të shohim se si shkojnë punët a po realizohen apo jo.

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

*M. Behluli*  
Kryesuesja e Komitetit për Komunitete  
Dr. Mirsada Behluli



---

Faqe 6 nga 6

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 381(0)38/230-900  
<http://www.prishtina-komuna.org>